

KOLUMNE



Goran Svillanoviq



Bashkëpunimi rajonal - si mund të funksionojë?

A e dini se kamionët me mallra nga Lubjana për në Tiranë udhëtojnë për më shumë se pesë ditë?

A e dini se prodhimi i përgjithshëm bruto (PPB) mesatar i vendeve të Evropës Juglindore përbën një të tretën e PBB-së mesatare të vendeve anëtare të BE-së?

A e dini se në pesë vitet e fundit vendet e rajonit e kanë dyfishuar borxhin e tyre publik, dhe se 800 000 persona i kanë humbur vendet e tyre të punës?

Infrastruktura dhe ekonomitë rajonale nuk janë të ndërlidhura aq sa duhet. Politika e ruajtjes së stabilitetit makroekonomik përmes rritjes së vazhdueshme të borxheve dhe të pushimit nga puna të punonjëseve ka çuar në pasoja dramatike në secilën familje të goditur, por edhe ka lëkundur rendin dhe vlerat demokratike të cilat janë themeli i shoqërive tona.

Ekonomitë e shtatë vendeve, të marra së bashku, janë zhvilluar aq sa vetëm ekonomia e Portugalisë. Kjo gjë duhet të ndryshojë!

Në fund të nëntorit 2013, në Sarajevë përfaqësuesit e Kosovës, Serbisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Shqipërisë, Malit të Zi, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kroacisë, miratuan një strategji gjithëpërfshirëse të përgatitur nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, të quajtur Evropa Juglindore 2020 — Krijimi i vendeve të punës dhe zhvillimi në perspektivën evropiane. Në Strategjinë EJL 2020 përfshihen shtatë qeveri që, me përkrahjen e KBR-së dhe Komisionit Evropian, janë të vendosura për të siguruar cilësi më të mirë jetese për qytetarët e tyre dhe për t'i udhëhequr ata drejt daljes nga kriza.

Në realitet, kjo do të thotë hapja e një milioni vendeve të punës në rajon në shtatë vitet e ardhshme, rritja e efikasitetit të energjisë me 9%, dhe e produktivitetit të qeverisë me 20%, dyfishimi i tregtisë dhe i investimeve, dhe në fund rritja e rendimentit me një të tretën.

Përveç këtyre, ka nevojë për një sistem arsimor i cili do ta rriste numrin e ekspertëve të rinj me arsim të lartë me 300 mijë, me mundësi realiste për punësim; rritjen e punësimit nga 39% në 44% dhe rritjen e xhiros së përgjithshme të tregtisë në rajon me më shumë se dy herë, nga 94 në 210 miliardë euro.

Këto janë vetëm thjesht shifra, por ato dëshmojnë për ambiciet e Strategjisë së EJL 2020, por edhe për ndërgjegjësimin që nga kriza nuk mund të dilet me pushime nga puna. Kriteret ekonomike për anëtarësim në Bashkimin Europian mbeten tërësisht të qarta - një ekonomi tregu funksionale dhe kapaciteti për konkurrueshmëri, gjithashtu aftësi për të konkurruar në tregun e Bashkimit Europian.

Kriza ka vënë në rrezik pikëpamjet për anëtarësim në Bashkimin Europian. Qytetarët e BE-së nuk e mbështesin anëtarësimin e vendeve që janë më të dobëta ekonomikisht në krahasim me vendet anëtare të BE-së. Zbatimi i plotë i strategjisë EJL 2020 dhe përmbushja e qëllimeve specifike dhe të matshme të përcaktuara në këtë strategji, është mënyra për të zbutur këto dallime, por edhe për t'iu afruar më afër standardeve të Bashkimit Evropian në edukim, punësim, kushtet e punës dhe produktivitet. Përveç rritjes së punësimit, qëllimi më i rëndësishëm i Strategjisë EJL 2020 është rritja e PPB-së së rajonit me rreth gjysmën e mesatares së vendeve anëtare të BE-së.

Në vitet në vijim detyra kryesore e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal do të jetë të sigurojë zbatimin e strategjisë EJL 2020. Për arritjen e këtij qëllimi, do të ngremë një sistem për monitorimin e progresit të përgjithshëm të secilit vend. Që tani kemi në fuqi një plan operativ dhe plan veprimi që përfshin ekonomitë e rajonit dhe deri në 20 ministri e agjenci për çdo vend, 15 koordinatorë rajonalë për sektorët, sektorin privat, shoqërinë civile, organizatat dhe donatorët ndërkombëtarë. Qytetarët do të informohen rregullisht për progresin e arritur nëpërmjet raportit vjetor të progresit të hartuar nga Komisioni Evropian.

Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë EJL 2020 - Krijimi i vendeve të punës dhe zhvillimi në perspektivën evropiane, e së bashku me të gjitha vendet e rajonit e ka mbështetur si një strategji të përbashkët për zhvillimin e rajonit. Në procesin e zbatimit të strategjisë EJL 2020, Kosova mund të presë mbështetje të plotë nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Komisionari i BE-së për zgjerim dhe Bashkimi Europian, siç u vendos edhe nga Këshilli i BE-së më 17 dhjetor 2013.

(Autori është sekretar i Përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe ish-ministër i jashtëm i ish-Jugosllavisë. Ky artikull është shkruar ekskluzivisht për gazetën Tribuna)